



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 51, datë 20.03.2025

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar (në mungesë)
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 20.03.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktim të përkohshëm”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 1016 prot., datë 19.03.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zonjën Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

- 
1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
 2. Me vendimin e KLP-së nr.260, datë 16.09.2021, prokurorja Dhorina Theodhori është caktuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Ushtrimi i këtij funksioni për prokuroren Theodhori, fillonte në datë 16.09.2021 dhe përfundonte në datë 16.09.2024.
 3. Me shkresën nr. 4255 prot., datë 26.06.2024, administruar në institucion me nr. 1487 prot., datë 27.06.2024, zonja Theodhori paraqet kërkesën për rikandidim në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, mbështetur në pikën 2 të nenit 52 të Ligjit për Statusin.
 4. Këshilli në zbatim të pikës 3, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, si dhe Rregulloreve “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar” dhe “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” me vendimin nr.144, datë 18.07.2024, ka filluar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, zonja Dhorina Theodhori, si dhe ka caktuar me short relatorin për këtë procedurë.
 5. Me vendimin nr. 26, datë 13.02.2025, Këshilli, vlerësoi të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Dhorina Theodhori, në kuadër të kandidimit për riemërim për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe lejin e kësaj kandidateje për të vijuar me procedurat e mëtejshme për riemërim.
 6. Këshilli në zbatim të neneve 52, 68 e vijues dhe 96 të Ligjit për Statusin, si dhe Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve” të ndryshuar, me vendimin nr. 406, datë 28.12.2023, përzgjodhi edhe prokuroren Dhorina Theodhori, për kryerjen e vlerësimi etik dhe profesionale individual gjatë vitit 2024, si dhe caktoi me short relatorin dhe Këshilltarin përgjegjës për këtë procedurë.
 7. Me vendimin nr. 42, datë 19.03.2025, Këshilli, miratoi Raportin e vlerësimit etik dhe profesional të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
 8. Pas miratimit nga ana e Këshillit të vendimit nr. 42, datë 19.03.2025, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës do ta paraqesë në mbledhjet pasardhëse të tij.

9. Në këto kushte, çmohet që të vijohet me instrumentin “caktim i përkohshëm” për caktimin e drejtuesit të zyrës së prokurorisë Korçë.
10. Duke qenë se, me vendimin nr. 272, datë 23.12.2024, të Këshillit zonja Theodhori është caktuar të ushtrojë funksionin e drejtuesit të zyrës së prokurorisë Korçë për një periudhë deri në tre muaj, afat që përfundon në datë 22.03.2025.
11. Ky propozim nga ana e Komisionit vjen në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon se:

“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera,*
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Në referim të nenit 42/2, të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se:

“... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

Referuar nenit 3 të Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin Nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, përcaktohet se:

Neni 3

Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve

- 1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.*
- 2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.*

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

12. Duke ruajtur frymën e ligjit dhe në përgjigje të situatës së krijuar, Këshilli vlerëson se, caktimi i përkohshëm i prokurores Dhorina Theodhori, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është në vijim të drejtimit të kësaj zyre prokurorie.
13. Ky caktim do të jetë për një afat deri në 3 muaj, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe Rregullore dhe mund të ndërpritet në çdo moment nëse Këshilli vendos riemërimin e prokurorit si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Rregulloren "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Zonja Dhorina Theodhori, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Zonja Dhorina Theodhori do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për një periudhë deri në tre muaj.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zonja Dhorina Theodhori do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Dhorina Theodhori, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 20.03.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erion Fejzulla